28.A The Formative Element **-ésë, -a**

kërkésë, -a	application, inquiry
kërkój	seek, apply, inquire (CF)
kërkim	seeking, search, research
vonésë, -a	tardiness, lateness
vonój	delay (CF)
vonim	delaying, delay
kthésë, -a	curve, turn
kthej	turn, return (CF)
kthim	return, turning
ftésë, -a	invitation, invitation card
ftoj	invite
ftim	inviting, invitation
martésë, -a	marriage
martój	marry off (CF)

The examples above illustrate the use of the formative element **-ésë, -a, -a**. This element, like the element **-im, -i, -e** is added to the last consonant in the stem of verbs whose stem CF ends in **-j**. The noun resulting from adding **-ésë** is not always sharply different in meaning from a noun resulting from the addition of **-im**, as you can see from the examples. However, in a vague way, **-im** nouns are usually "dynamic", while **-ésë** nouns are usually "static". Not all verbs whose CF ends in **-j** have corresponding nouns with both of these elements. For some verbs there is only a corresponding **-ésë** noun: e.g., **martój** 'marry off' (CF). But for the majority there is only a corresponding **-im** noun: e.g., **importój** 'import' (CF), **fillój** 'begin' (CF) **këndój** 'sing' (CF).

28.B The Ablative Suffix **-sh**

dru pýjesh	lumber ("wood from forests")
pyll, -i, pýje	forest
mozaik ngjyrash	mosaic of colors
nyjyrë, -a	color
zogj púlash	chicks ("birds of chickens")
púlë, -a	chicken
búrrë grash	ladies' man
grúa, -ja, gra	woman

The suffix **-sh** is added to plural stems, and is the plural correspondent of the singular dative indefinite suffix **-i** or **-u** (with singular masculine stems), and **-e** or **-je** (with singular feminine stems) in its ablative case uses. The suffix **-sh** is used primarily when the noun it is suffixed to immediately follows another noun and serves to

characterize that noun in some way, like the singular dative indefinite suffix in such constructions as **mish viçi** veal ("meat of calf"), **mish púle** 'chicken' ("meat of chicken"). Many people also use the ablative (i.e. dative indefinite) forms as object of the preposition **prej** when used in the sense 'of' and some people even use these forms after other dative prepositions.

28.C The Formative Element **-si, -a**

lartësi, -a	height
i lartë	high
qetësi, -a	quietness, peacefulness
i qétë	quiet
mundësi, -a	possibility
mund	can, be able (CF)
shpejtësi, -a	speed, rapidity
shpejt	fast, early
bujqësi, -a	agriculture
bujk, -u, bujq	farmer

The element **-si, -a** (productive) is added to stems, generally adjective stems, to form abstract nouns. It often corresponds to one of the English elements **-ness** or **-ity** as in quiet*ness*, rapid*ity*, gentle*ness*, possibil*ity*, white*ness*, tranquil*ity*, etc.

28.D The Formative Element **-ës,-i, -(it)**

mirëpritës, -i, -(it)	welcomer
pritur	waited (participle)
rrobaqépës, -i -(i)	tailor
qépur	sewn (participle)
mësúes, -i, -(it)	teacher
mësúar	taught (participle)
banúes, -i, -(it)	resident
banúar	resided (participle)
shërbýes	servant
shërbýer	served (participle)

The element **-ës, -i, - (-it)** may be added to the participle stem of a verb to form a noun designating someone with an active characteristic of that stem. If the participle ends in **-úar** or **-ýer**, a stem ending in **-úe** or **-ýe** is used and the **ë** of the suffix is dropped.

Notice that the plural stem of nouns ending in this element is identical to the singular stem, but that the vowel **-i-** is inserted between the stem and the plural definite suffix **-t**. This is symbolized by the **(-it)** in the citation formulas above.

28.E Kinship Terms

The following are the principal terms used for close relatives:

babá, -i, -llárë	father

nënë, -a	mother
djálë, -i, djem	son (boy)
vájzë, -a	daughter (girl)
búrrë, -i, -a	husband (man)
grúa, -ja, gra	wife (woman)
vëllá, -i, vëllézër	brother
mótër, -a	sister
xhaxhá, -i, -llárë	uncle (father's brother)
daí, -u, dajllárë	uncle (mother's brother)
hállë, -a, -a	aunt (father's sister)
téze, -ja	aunt (mother's sister)
gjysh, -i, -ë	grandfather
gjyshe, -ja	grandmother
nip, -i, -ër	nephew
mbésë, -a, -a	niece
kushëri, -ri, -nj	cousin (male)
kushërirë -a, -a	cousin (female)
vjéhërr, vjéhrri	father-in-law
vjéhërr, vjéhrra	mother-in-law
kunát, -i, kunétër	brother-in-law
kunátë, -a, -a	sister-in-law
njerk, -u	step-father
njérkë, -a, -a	step-mother

As with other kinds of nouns, a possessive adjective used with one of these kinship terms usually follows it. In this type of construction the kinship term has a definite suffix. For example:

Babai im banon në Berat.	My father lives in Berat.
E njoh nipin tënd.	I know your nephew.
Erdhi pas hallës së tij.	He came after his aunt.

Unlike most other nouns, however, a kinship term may be used--usually as a mark of intimacy--with its possessive adjective preceding it. We have already seen in the Analysis of Unit 27 that a third person possessor can be expressed by an adjectival particle preceding the kinship term in a definite case. When a 1st or 2nd person singular possessor precedes, however, the kinship term is indefinite.

The 1st person singular adjective *my* has the following forms in such constructions (no plural forms are given, because plural forms of this construction are not used):

	Masculine	Feminine
Nominative	**im**	**ime**
Accusative	**tim**	**time**
Dative	**tim**	**sime**

The 2nd person singular adjective *your* has the following forms in the same constructions (again, only singular forms are involved):

	Masculine	*Feminine*
Nominative	**yt**	**jot**
Accusative	**tët**	**tët**
Dative	**tët**	**sat**

The kinship term in such constructions takes only singular indefinite case suffixes:

	Masculine	Feminine
Nominative and Accusative	**at bir shoq**	**ëmë bijë shóqe**
Dative	**éti biri shóqi**	**ëme bije shóqeje**

Combining the tables above, here are the words **bir** 'son' and **bijë** 'daughter' in combination with preceding **im** 'my' and **yt** 'your':

Nominative	**im bir**	**ime bijë**
	yt bir	**jot bijë**
Accusative	**tim bir**	**time bijë**
	tët bir	**tët bijë**
Dative	**tim biri**	**sime bije**
	tët biri	**sat bije**

LISTENING IN 28

Conversation 1
Skënderi: Të kërkoja gjithë ditën sot.
Luani: Pse? Ke ndonjë punë?
Skënderi: Kam, po. Dua të më përkthesh një këngë.
Luani: Në ç'gjuhë është kënga?
Skënderi: Kënga është në gjuhën frëngjishte.
Luani: Interesant. Dhe ku e gjete këngën?
Skënderi: E pashë në një libër frëngjisht në bibliotekën e universitetit.
Luani: Më vjen keq po sot s'e bëj dot.
Skënderi: Pse? Nuk ke nge?
Luani: Harrove, Skënder? Sot është dita e festivalit kombëtar.
Skënderi: Mirë thua. Më doli nga mendja.
Luani: Po të duash, e përkthej nesër këngën.
Skënderi: Të falemnderit. E lemë për nesër.

Conversation 2
Gjergji: Ku po shkon, Selman?
Selmani: Shkoj në stadiumin sportiv, natyrisht.
Gjergji: Pse, natyrisht?
Selmani: Nuk e di? Sot atje fillon Festivali i Gjirokastrës. Do të vish me mua?
Gjergji: Unë e pashë herën e fundit.
Selmani: Ohu! Domethënë pesë vjet të shkuar.
Gjergji: Tamam. Më 1973.
Selmani: Dëgjo, Gjergji. Festival sivjet është më i mirë se kurdoherë më parë.
Gjergji: Ku e di ti?
Selmani: Besomë mua. Kanë ardhur, bile, dhe folkloristë nga vendet e jashtëm për të bërë sehir.
Gjergji: Vërtet?
Selmani: Pa shaka. Atëherë do vish me mua apo jo?
Gjergj: Do vij domosdo.

Conversation 3
Zefi: Je veshur me kostum sot.
Nikolla: Të pëlqen?

Zefi: Posi. E kujt s'i pëlqen fustanella e shqiptarit?
Nikolla: E kam trashëgim nga babai.
Zefi: Po qeleshen e bardhë?
Nikolla: Edhe atë e kam trashëguar nga im atë.
Zefi: Dua të të marr në fotografi. A më lejon?
Nikolla: Prit një minutë sa të krihem një çikë.
Zefi: Mos u bëj merak, se mirë do të dalësh.
Nikolla: Po ti pse e do fotografinë time?
Zefi: Për kujtim, asgjë tjetër. Nikolla: Bëj dy, të lutem, dhe një fotografi ma jep mua. Zefi: Si të duash, shoku Nikolla.

Unit 29

Finding out About Albania

Pas kthimit të tij në Amerikë, Arbeni fjalòset me Zotin Beqir Hajdarin në Boston.

Arbeni

gazetár, -i, -ë	journalist
artíkull, -i, artíkuj	article
Unë jam gazetar, dhe më pëlqen të shkruaj një artikull përmbi Shqipërinë.	I'm a journalist, and I'd like to write an article about Albania.
lexój	read (CF)
líbër, -i, -a	book
të cílët	which (masc.)
Kam lexuar ca libra të cilët ishin shkruar shumë vjet më parë.	I have read some books (about it) which were written many years ago.
pákëz	a little bit
jétë, -a	life, time
i tanishëm	present
A mund të më thoni pakëz mbi jetën e tanishme?	Could you tell me a little about recent times?

Beqir Hajdari

interesój	interest (CF)
më shumë	more, most
Çfarë gjë ju intereson më shumë?	What sort of thing interests you most?

Arbeni

ngjárje, -ja, -	event, happening
fund, -i, -e	end, bottom, last
Ngjarjet e fundit.	The most recent events.

Beqir Hajdari

siç	as
mbretëri, -a, -	kingdom
Siç e di, Shqipëria ishte një mbretëri gjer më një mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë.	As you know, Albania was a kingdom until 1939.

Arbeni

okupój	occupy (CF)
okupói	(it) occupied (past def.)
Më duket se kjo ishte koha kur Italia okupoi Shqipërinë?	Wasn't that when Italy occupied Albania ("it seems to me that this was the time when...")?

Beqir Hajdari

íkje, -ja, -	leaving, departure
mbret, -i, -ër	king
qeveritár, -i, -ë	governmental official

formój — form (CF)
formúan — (they) formed (past def.)
Mbas ikjes së mbretit dhe të qeveritarëve, italianët formuan atëherë një qeveri.
After the departure of the king and his cabinet, the Italians then formed a government.

gjithashtú — likewise
parlamént, -i, e — parliament
Gjithashtu, dhe një parlament.
And likewise a parliament.

rast, -i, -e — occasion, chance, instance
shumicë, -a, -a — majority, crowd
kúndër — against (with dative)
bashkëpunój — cooperate (CF)
bashkëpumním, -i, -e — cooperation
Në këtë rast, shumica e popullit ishte kundër bashkëpunimit me italianët.
This being the case ("in this case"), the majority of the people was opposed to cooperation with the Italians.

Arbeni

ngjan — (it) happens
ngjáu — (it) happened (past def.)
Çfarë ngjau pastaj?
What happened then?

Beqir Hajdari

formóhet — form oneself, be formed (medio-passive)

politík, politíke — political
rezistój — resist (CF)
luftój — fight (CF)
Ú formuan grupe të ndryshëm politike për të rezistuar dhe luftuar italianët.
Various political groups were formed to resist and fight the Italians.

Arbeni

Këta grupe, ishin të bashkuara?
These groups, were they united?

Beqir Hajdari

fillím, -i, -e — beginning, start
Në fillim, po.
In the beginning, yes.

u ndánë — (they) separated (medio-passive, past def.)

komunist, -i, -ë — communist
bállë, -i, - — front, forehead
Por më vonë, u ndanë në Komunistë dhe në Balli Kombëtar.
But later they were divided into Communists and the National Front.

Arbeni

ekzistój — exist (CF)
më — more, any more
Ekzistojnë më këto parti?
Do these parties exist still ("more")?

Beqir Hajdari

kátrën — (the) four (accusative)
në dýzet e kátrën — in forty-four
Ballíst, -i, -ë — Frontist
nacionalíst, nacionalíste — nationalist

Në dyzet e katrën Ballistët dhe të gjithë grupet nacionaliste dolën jashtë atdheut.

In 1944 the Frontists and all the nationalist groups left ("emerged out of") the country.

Arbeni

íkën (they) left (past def.)
mërgój banish
mërgim, -i, -e emigration, exile
íkën në mërgim (they) went into exile
Domethënë, íkën në mërgim? You mean they went into exile?

Beqir Hajdari

Po. Yes.

shtrëngój compel, constrain
u shtrëngúan (they) were compelled (medio-pass., past def.)
nga by (with nominative)
árdhje, -ja, - arrival, coming
komunízëm, -i communism
fuqí, -a, - power
U shtrënguan nga ardhja e komunizmit në fuqi. They were compelled to by the arrival of communism into power.

Arbeni

Por tashti, ç'thua? And what do you think now?

gjéndet (it) is situated (medio-passive)
Si gjendet atje? How are things there ("how is it situated there")?

Beqir Hajdari

më sa as far as, inasmuch
Më sa di unë, nuk është keq. As far as I know, it's not bad.

përpára before (with dative)
lúftë, -a, -ra war
vúan, vúajtur suffer
mungój lack, be absent
mungésë, -a, -a lack, absence
Përpara luftës populli vuante nga mungesa e ushqimit. Before the war, the people used to suffer from the lack of food ("foodstuff").

nga ana tjétër on the other hand, moreover

përháp spread (CF)
përhápje, -ja, - spread, diffusion
sëmúndje, -ja, - disease, illness
Dhe nga ana tjetër, nga përhapja e madhe e sëmundjeve. And what's more, from widespread disease ("and moreover, from the great spread of diseases").

Arbeni

Përse? Why?

kishte	there was ("it had")
iláç, -i, -e	medicine
S'kishte ilaçe?	Wasn't there any medicine ("medicines")?

Beqir Hajdari

(clicks his tongue and moves his head up slightly)	Unh-unh. (In English accompanied by a shake of the head)

Arbeni

i shkrétë	deserted, damned, wretched
e shkréta	the wretched one (feminine)
E shkreta Shqipëri.	Poor Albania

Beqir Hajdari

Ashtu ishte atëherë, por jo më.	That's the way it was then, but no more.
bëj ballë	confront ("make front")
i vështirë	difficult, trying
vështirësí, -a. -	difficulty, trouble
i vet	(one's) own
Tani, vendi u bën ballë vështirësive të vet.	Now the country is facing up to its problems.

Arbeni

mérrni	(you/pl) take, get
shpesh	often
A merrni lajme shpesh nga Shqipëria?	Do you get news from Albania often?

Beqir Hajdari

rrállë	seldom
Shumë rrallë dhe me vonesë.	Very seldom, and late ("with much lateness").
Si thua?	Well, what do you say?
idé, -ja, -	idea
A keni mjaft ide për të shkruar artikullin?	Do you have enough ideas to write the article?

Arbeni

akóma	yet, still
Jo akoma.	Not yet.
po	but
megjíthatë	even so, however
nátë, -a, nétë	night
vizítë, -a, -a	visit
Po megjithatë, një nga këto netë do të vij të të bëj një vizitë në shtëpi.	However, one of these nights I'll come over to pay ("make") a visit to you at home.

Beqir Hajdari

mirëprés, mirëpritur	welcome (CF)
përgjígjet	answer (medio-passive)
u përgjigjet pyetjevet	answer the questions ("to the questions")

Je i mirë pritur, dhe gjithnjë jam gati t'u përgjigjem pyetjevet tuaja.	You are welcome, and I'm always ready to answer your questions.

ANALYSIS 29

29.A The Adjectival Particles **i, e, të, së**

The following table summarizes the rules for using the various adjectival particle forms. As you know, the form of the adjectival particle depends on its referent. In this table a hyphen (-) placed before a form indicates that that form is used only when its referent immediately precedes it. The alternant given with such forms is used if the referent does not immediately precede:

	Singular				*Plural*	
	Masc. Def.		*Fem. Indef.*		*Masc. Def.*	
Nom.	**i**	**i**	**e**	**e**	**-e, të**	**të**
Acc.	**-e, të**	**të**	**-e, të**	**të**	**-e, të**	**të**
Dat.	**të**	**të**	**së, të**	**të**	**të**	**të**

A few examples will illustrate some of these forms. The adjectival particles are italicized.

Ësnë këshilltari *i* **ministrit** *të* **punëvet** *të* **jashtme.**
Inspektori *i* **ministrisë** *së* **brendshme** *të* **Shqipërisë.**
Shtetet *e* **Bashkuara** *të* **Amerikës.** ("the United States of America")
--për zhvillimin *e* **madh** *të* **sëmundjeve.**
u formuan grupe *të* **ndryshme.**
Është një përallë *e* **bukur.**
Kish një vulë *të* **vjetër.**
Shumica *e* **popullit ishte kundër bashkëpunimit.**
Jam *i* **sigurt.** (Here *I* is a male.) Jam *e* sigurt. (Here *I* is a female.)

29.B The Formative Element **-isht**

frëngjisht	in French
anglisht	in English
zakonisht	customarily, usually
sigurisht	certainly
natyrisht	naturally

The element **-isht** forms adverbs from noun or adjective stems. One of the functions is to form "language adverbs" like **frëngjisht** and **anglisht** as well as **turqisht** 'in Turkish', **greqisht** 'in Greek', **rusisht** 'in Russian', **gjermanisht** 'in German', etc. In its other functions, it resembles the element *-ly* in English words like *sweetly, shortly, simultaneously, wrongly,* etc.

29.C Compounding of Stems

bashkë-punój	cooperate, work together (CF)
bashkë-punim, -i	cooperation

310

fat-kéq	unfortunate
fat-keqësisht	unfortunately
mirë-prés	welcome (CF)
i mirë-pritur	welcome (adjective)
vaj-gúr, -i	petroleum ("oil-rock")
at-dhé, -u	fatherland, homeland
para-ushtarák, -u, -ë	cadet
nën-togér, -i, -a	second lieutenant ("sub-lieutenant")
krye-qytét, -i, -e	capital ("head-city")
hekur-údhë, -a	railroad ("iron-road")
kokë-tráshë	stupid, fat-head (adjective)
për-mbi	concerning (with accusative)

Another productive way of forming stems is to put together two otherwise independent stems, rather than one stem and a formative suffix element. Several examples of such compounding are listed above. (In actual Albanian writing, no hyphen appears between the elements). Notice the following characteristics of such compounds:

(a). The stem formed by combining two stems is of the same stem class (noun, verb, adjective, adverb, preposition) as the second stem in the combination. Suffixes or formative elements added to the compounded stem are generally those which are appropriate for the second stem component rather than for the first. Thus **bashkëpunój** is a verb, like **punój** and takes the same suffixes and formative elements as **punój**. Also, the general use of the compound is parallel to the use of its second component. Thus, **kryeqytét** appears in places where you might also find **qytet**, but not where you would find **krye**.

(b). Syntactically, compounds formed with a noun and an adjective (**fatkéq, kokëtráshë**) are used as adjectives without adjectival particles. Notice that this is not true if the adjective has been secondarily derived from a participle (**i mirëpritur**).

(c). As in English compounds like *blackbird, horseshoe, railroad,* semantically and syntactically the first element is subordinate to the second, rather than vice versa. Thus, *blackbird* is a kind of bird, not a kind of black. Similarly, **atdhé** is a kind of land, not a kind of father; **bashkëpunój** is a kind of work, not a kind of together, etc. However, the opposite is true for the noun-adjective compounds discussed in (b).

(d). In compounds the primary stress is always on the second component, but secondary stress may be on the first component.

(e). Finally, you will see from these and other like examples that the meaning of the compound is not always a simple, direct addition of the meanings of its components. For this reason, compounds should be treated like new words, whose meanings can be learned and made precise only by the contexts of the situations in which they occur.

29.D Interrogative **cil-** *and Relative* **i cil-**

From the stem **cil-** two sets of forms are made: (a) the question-asking set without adjectival particles, and (b) the RELATIVE ADJECTIVE set with adjectival particles. In form, both sets are like adjectives in that the choice among them depends on the gender, case, and number of the referent. Depending on that referent (see Analysis, Unit 10) the **cil-** stem takes different definite case suffixes. For the relative adjective set, the appropriate adjectival particle precedes the stem, as indicated below in parentheses:

	Singular		*Plural*	
	Masc.	*Fem.*	*Masc.*	*Fem.*
Nom.	**(i) cili**	**(e) cila**	**(të) cilët**	**(të) cilat**
Acc.	**(të) cilin**	**(të) cilën**	**(të) cilët**	**(të) cilat**
Dat.	**(të) cilit**	**(së) cilës**	**(të) cilëvet**	**(të) cilavet**

Examples from both sets are given below:

(a)

Cili do të shkojë me ju?	Who (masc.) will go with you?
Dua të di cila është ajo?	I want to know who she is?
Cilin pe në park?	Whom (masc.) did you see in the park?
Me cilën u llafose?	With whom (fem.) did you speak?
Banoni afër cilit?	You live near which (masc.)?
Cilës ia dha?	to whom (fem.) did he give it?
Cilët janë ata?	Which (or who) are they (masc.)?
Cilat janë ato?	Which (or who) are they (fem.)?
Cilëvet duhet t'ua them?	To whom (masc.) should I tell it?t
Mbas cilavet vij unë?	After which (fem.) do I come?

(b)

Është burri i cili ka bërë më shumë për Shqipëri.	He's the man who has done most for Albania.
E njoh vajzën të cilën ju patë.	I know the girl whom you saw.
Unë e di mirë çupën e së cilës është.	I know well the girl whose it is.
Ku janë ata emrat të cilevet janë shkruar në librin?	Where are those whose names are written in the book?
Njerëzit të cilët mësojnë shqipen duhet të punojnë shumë.	People who study Albanian must work hard.

29.E Albanian Names

In this Unit the Albanian's name is **Zoti Beqir Hajdari**. Notice that **zoti** 'Mr.' always has a definite suffix in the appropriate case. A masculine first name (**émër**) never takes a suffix when followed by a surname (**-mbiemër**). In most other occurrences in a sentence--all except the vocative use of simply calling or naming the person--a person's name has a definite suffix in the appropriate case. Feminine names commonly end in **-a**, even in vocative uses and before a surname.

LISTENING IN 29

Conversation 1

Abasi: Çfarë ke që je i dëshpëruar?
Hasani: Sot mora një letër nga shtëpia. Dhe nëna më lajmëron përmbi fatkeqësitë që pësojnë.
Abasi: Pse? Ç'u ka ngjarë?
Hasani: Janë të shtrënguar të ndërrojnë shtëpinë. Se i zoti i shtëpisë do ta shesë.
Abasi: Dhe ku do të venë të banojnë.
Hasani: Me sa më shkruajnë, tek një fqinjë gjer në fund të muajit.
Abasi: Mirë, po ti, pse mërzitesh?
Hasani: Se ndërrimi i shtëpisë kushton para. Dhe është pak vështirë të gjesh një tjetër vend.
Abasi: Kur duhet të ikin nga shtëpia?
Hasani: Më njëzet e tre shkurt.

Conversation 2

Ullmari: Pse janë kaq shqiptarë jashtë Shqipërisë?
Aliu: Përpara shumë vjetve disa nga ata lanë atdheun për të kërkuar një jetë më të lumtur. Dhe nga ana tjetër disa të tjerë ikën tashti në kohët e fundit në mërgim për arsye politike.
Ullmari: Të gjithë shqiptarët flasin të njëjtën dialekt?
Aliu: Në filim, gjuha shqipe u nda në dy grupe kryesorë: tosk e gegë. Më vonë u formuan dialekte të ndryshëm.
Ullmari: Në ç'mënyrë?
Aliu: Shumica nga importimi i fjalëve prej gjuhëve të huaja të fqinjëvet tonë.
Ullmari: Librat që ekzistojnë, në çfarë dialekt janë shkruar?
Aliu: Disa gegë e disa toskë. Por në kohën e tanishme, gazetarët përdorin gjuhën letrare kombëtare.
Ullmari: Po në shkollat, në çfarë dialekt mësohet shqipja?
Aliu: Gjithashtu, edhe në shkollat mësohet gjuha letrare kombëtare e normalizuar.

Conversation 3

Asllani: O, i shkreti unë. S'kam më fuqi. Nuk e di, ndofta jam i sëmurë.
Ylli: Duhet të marrësh ndonjë ilaç.
Asllani: Nuk e di çfarë të marr.
Ylli: Kam lexuar në një artikull në gazetë që shumë njerëz ndodhen të sëmurë.
Asllani: Më mirë të bëj një vizitë te doktori.
Ylli: Edhe gruaja ime ishte e sëmurë ca ditë. Dhe doktori i dha ca ilaçe, dhe duket që tashti është më mirë. Prandaj shpresoj gjithashtu dhe për ty, që të bëhesh më mirë.

313

Unit 30

Fifth Review

Conversation 1

Qemali: Ej, erdha kastile që të bëjmë ca fotografi. Eja të dalim përjashta.
Petriti: Ç'e do? Do që të kesh kujtim fytyrën time?
Qemali: Po. Dua ta marr me vete kur të vete në ushtri.
Petriti: Më parë bëjmë një këtu. Mund të marrim gjithë pamjen e fushës.
Qemali: Ku të qëndroj? Këtu o atje?
Petriti: S'prish punë. Vetëm ujdis trupin dhe ndreq këmishën.
Qemali: Mbas kësaj, dua të bëj edhe një me gjyzlykë.
Petriti: Hiqe dorën nga xhepi dhe shiko drejt këtu. Gati?
Qemali: Hajde të bëjmë një bashkë tashti. Sa film ke akoma?
Petriti: Sa për katër.

Questions

1. Ç'do të bëjnë ata?
2. Ku do t'i bëjnë.
3. Pse e do?
4. Çfarë ujdis Qemali?

Conversation 2

Sami: Me të vërtetë mbeta shumë i kënaqur nga kjo vizitë. Dëshiroja që t'i vizitoja të gjitha ato vende, por fatkeqësisht s'patëm kohë.
Gjergji: S'është çudi që për së shpejti të shkojmë edhe një herë tjetër atje. Kështu që mund ta kompletojmë vizitën tonë.
Sami: Autoritetet e atjeshëm na kanë bërë nder shumë, sidomos kryetari i komitetit ekzekutiv.
Gjergji: Të gjithë janë mikpritës (*hospitable person*) në ato fshatra.
Sami: Nuk kuptova kush ishte ai që mbante një shkop dhe çalonte pak.
Gjergji: Ai ishte kunati i doktorit. Tashti është plak, por përpara ka qenë inspektor.
Sami: Dukej gjithnjë me qejf.

Questions

1. A është i kënaqur Sami nga vizita?
2. Kush i ka bërë nder shumë?
3. Si janë njerëzit në fshatra?
4. Kush është plak tashti?

Conversation 3

Hasani: Këtë radhë duhet të më shoqërosh edhe ti.
Faiku: Pse? Ku po përgatitesh të shkosh?
Hasani: Dëshiroj të vizitoj Aliun në shtëpi.
Faiku: Pse? Do ta urosh për martesën e tij?
Hasani: Po. E kam për detyrë, se është miku im.
Faiku: Atëherë, vemi bashkë, se edhe unë s'e kam uruar

akoma.
Hasani: Rrofsh (*May you live! Good for you!*) atëherë. Le të shkojmë tashti. Kështu mund të gjejmë edhe prindërit e tij në shtëpi.
Faiku: Përveç kësaj, duhet të marrim parasysh se unë në orën njëmbëdhjetë duhet të jem në bankë. Kam për të dorëzuar ca para.
Hasani: Atëherë, le të mos vonohemi! Nga ç'udhë do të shkojmë?
Faiku: Besoj më mirë t'ia marrim nga monumenti.
Hasani: Edhe mua më duket se ajo rrugë është më e shkurtër.

Questions

1. Ku po shkon Hasani?
2. Pse do ta vizitojë?
3. Ku duhet të jetë Faiku në orën njëmbëdhjetë?
4. Nga ç'udhë do të shkojnë?

Conversation 4

Sadiku: E lexove librin që të dha im atë?
Ramizi: Jo të gjithë. Shpresoj ta mbaroj në fund të javës. Pse? I nevojitet?
Sadiku: Jo, por unë kam një tjetër libër që dëshiroj ta lexosh.
Ramizi: Shpresoj ta gjej interesant. Kur është shtypur libri?
Sadiku: Është shtypur dy tre muaj të shkuar nga Ministria e Arsimit.
Ramizi: Kush e ka shkruar?
Sadiku: Është shkruar prej shumë njerëzve. Një nga ata është dhe Androkli Kostallari.
Ramizi: Në kohët e fundit kam lexuar shumë shkrime të këtij dhe më kanë pëlqyer.
Sadiku: Le të shpresojmë se dhe libri që do të të jap unë do të të pëlqejë.

Questions

1. Kur do ta mbarojë librin Ramizi?
2. Pse Sadiku e pyet?
3. Kur u shtyp libri?
4. Kush e ka shkruar?

Conversation 5

Arbeni: Çfarë pune bën babai yt?
Thimiu: Ai është tregtar.
Arbeni: Çfarë lloj mallrash importon Shqipëria?
Thimiu: O, ekzistojnë pak plaçka që ne detyrohemi ("*we are compelled*") t'i blejmë nga shtetet e huaja. Si për shembull vegla për bujqësi, makina, etj.
Arbeni: S'keni fabrika në Shqipëri?
Thimiu: Kemi, posi. Në kohët e fundit janë bërë disa të reja.
Arbeni: Po kur eksportoni, çfarë nxirrni jashtë atdheut?
Thimiu: Lesh, lekurë, perime, e të tjera.
Arbeni: Në ç'shtet i shitni?
Thimiu: Në Greqi, Itali, Francë, dhe gjetkë (*elsewhere*)
Arbeni: Besoj se ti punon bashkë me babanë?
Thimiu: Po. Kështu që përmirësojmë ekonominë tonë.

315

Questions

1. Çfarë bën babai i Thimiut?
2. Pse detyrohen të importojnë?
3. Çfarë mallra?
4. Ku i dërgojnë leshin dhe lëkurët?

Conversation 6

Llazari: Hej. A e ke lexuar këtë libër?
Fatmiri: Nuk kam patur rastin ta lexoja. Ç'thotë?
Llazari: Flet për mbi luftën dhe rezistencën që kanë bërë shqiptarët në luftën e dytë botërore.
Fatmiri: Në atë kohë në Shqipëri, më duket se ishin italianët?
Llazari: Po. Por në 1940, thotë libri, paskan qenë të bashkuar të gjithë grupet politike për të luftuar për lirinë e Shqipërisë.
Fatmiri: A ka qenë në fuqi një qeveri e formuar me të gjitha partitë politike?
Llazari: Jo. Nuk mund të formohej një qeveri e tillë.
Fatmiri: Pse? Çfarë ka qenë arsyeja?
Llazari: Partitë nacionaliste u shtrënguan të linin atdheun për arsye të ardhjes së partisë komuniste në fuqi.

Questions

1. Përmbi çfarë flet libri?
2. Në ç'kohë ishin të bashkuar?
3. Pse?
4. Pse ikën nacionalistët?

Vocabulary

In the following vocabulary list, the Unit number given is that of the first appearance of the Albanian word in the sense indicated by the English approximation. For words from Unit 1, the dialogue subsection is indicated by a number .01, .02, etc. A dagger sign (†) indicates that the word first appears in the supplementary Vocabulary section of the Unit indicated.

The alphabetical order of adjectives preceded by an adjectival particle is determined by the stem of the adjective; such adjectives are indicated by an adjectival particle **i, e, të** between parentheses. Adjectives with special feminine forms may have that form indicated after a comma, followed simply by **-e**, if the feminine stem is identical to the masculine except for the addition of that suffix. Nouns are cited followed by their nominative singular definite suffix, and their plural suffix, if appropriate. Regular verbs are indicated by the (CF) designation used in the Units themselves; irregular verbs are cited, as in the Units, with the participle, past definite (1st person singular), and other unpredictable forms, as appropriate.

Albanian----English Approximation----Unit

a whether (question particle) *1.02*
  a nuk don't you think so? *3*
a or (used with opposites) *14*
aeroplán, -i, -ë airplane *26*
aeropórt, -i, -e airport *26*
áfër near, by *2*
áfër nearby, close *3*
  áfër dérës near the door *2*
afróhet approaches (medio-passive) *13*
afrój bring near (CF) *13*
Agróni (proper name) *2†*
ah ah! *16*
aí he, that one *2*
ai that (masc.) *7*
ajó she *2*
ajó she, that one *4*
akóma still, yet *9*
aksión, -i, -e action, undertaking *28*
ákull ice-cold *5†*
akullóre, -ja ice cream *16*
amá (expression of satisfaction) *8*
amerikánë Americans (masculine) *2*
Amerikë, -a America *2*
andéj in that direction *5*
anembánë all around *19*
ánë, -a, - side *1.03*
  point of view *25*
  direction *9*
ánës along, beside (with dative) *25*

angarí, -a compulsory labor *23*
angléz, -i, -ë Englishman *2†*
Anglí, -a England *2†*
anglísht in English *2*
aparát fotografík camera *28*
apó or *8*
aq so, such *1.01*
aq...sa so...that *23*
ar, -i gold *28*
arabísht Arabic *1†*
arançátë, -a orangeade *1†*
Arbéni (proper name) *2†*
árdhje, -ja, - arrival, coming *29*
árdhur come (participle) *13*
árë, -a, -a field *22*
armík, -u, armiq enemy (masculine) *17*
armíke, -ja, - enemy (feminine) *17*
arsím, -i, -e education *27*
arsýe, -ja, - reason *27*
artíkull, -i, artíkuj article *29*
as not, nor *3*
not even *26*
asgjë nothing *3*
asnjëhérë no time, never *16*
asnjë none, not one *15*
no *19*
aspák not at all, none *28*
ashtú in that way, so *5*
ashtú so, thus *1.01*
atá they, those (masculine) *4*
atdhé, -u fatherland, homeland *22*
átë, -i, étër father, sire *21*
atë that (masculine) *2*
her, him, it *14*
atëhérë then *7*
atíj to him *2*
that (masculine dative) *20*
atje there *1.03*
ato gjëra that kind of thing *28*
atý there nearby *8*
atý për atý right there *8*
atýre to them (dative) *13*
autobús, -i, -ë bus *X10†*
autoritét, -i, -e authority, official *26*
aviatór, -i, -ë aviator *4*
avokát, -i, -ë lawyer *4*

babá, -i, baballárë father *2*
bakáll, -i, bakéj grocer *9†*
baklláva, -ja, - sweet pastry filled with nuts *8†*
bakshísh, -i, -e tip, charity *16*
báltë, -a, -ëra mud *22*
ballë, -i, - front, forehead *29*
Ballíst, -i, -ë Frontist *29*
bámje, -a, - okra *8†*
bánkë, -a bank *9*
banój reside, live (CF) *4*
banór, -i, -ë inhabitant *25*
bánjë, -a, -a bathroom *X11†*
bar, -i, -ëra grass *20*

(i) bárdhë white *8*
báshkë together *9*
bashkëpunim, -i, -e cooperation *29*
bashkëpuno cooperate (CF) *29*
bashki, -a, - city hall *2†*
bashkój join (CF) *26*
(i) bashkúar joined *26*
baúlle, -ja, - chest, trunk *27*
behár, -i summer *5*
bëj, bërë (bëra) make, do *1†*
bëj bállë confront *29*
bëj fjálë argue *10*
talk about *28*
bëj qéjf have a good time *13*
bëj shaká make joke *14*
bëj muhabét have pleasant talk *20*
bëj sehir enjoy the show *27*
bëhet becomes, is made (medio-passive) *22*
bëhet merák I worry *15*
bëhet trégu the market is held *25*
bel, -i, -e waist, small of back *20*
berbér, -i, -ë barber *9*
bereqét, -i, -e crop *22*
bésë, -a, - pledge, faith *17*
besnik, -u, -e men of faith, loyal *17*
besój believe, suppose (CF) *5*
bezdis bother (CF) *11*
bezdiset gets bothered (medio-passive) *11*
bibliotékë, -a, -a the library *1†*
biçiklétë, -a, -a bicycle *X10†*
bie, rënë (rashë) fall *5*
bie dëbórë (it) snows *5*
bie shi (it) rains *5*
bie muzikës play music *14*
bie përqark take a tour around *10*
bie, prúrë (prúra) bring *28*
biletë, -a ticket *16*
bir, -i, bij son *13*
birrë, a beer *1†*
bisedój discuss (CF) *25*
bitis complete, finish (CF) *23*
bitiset gets completed (medio-passive) *23*
bizéle, -ja pea *8*
bjer bring! (singular command) *9*
blej buy (CF) *3*
bletë, -a, - bee *22*
blu blue *15*
blúzë, -a, -a blouse *9†*
bójë, -a, -ra color, paint *15*
bójë hiri color of ashes, gray *26*
bojë deti navy-blue, sea-color *15*
bojëkáfe brown *15*
borxh, -i, -e loan *16*
bostán, -i, -e melon *16*
bosh empty *7*
bótë, -a world *20*
botëróre worldwide *13*
botój publish (CF) *27*
bredh, brédhur (bródha) run *16*

brékë, -t shorts (plural only) *15*
brénda inside (followed by dative) *7*
brenda këtýre ditëve within a few days *27*
brénda në inside (followed by accusative) *7*
(i) bréndshëm internal *26*
bréshër hail *5†*
brez, -i, -a belt, waist *27*
brez, -i, -a generation *17*
brisk, -u, brisqe razor blade *9*
brýmë, -a frost *5†*
brýmë e madhe heavy frost *5†*
buçás (buçet), buçitur roar *28*
Bujári (proper name) *2†*
bujk, -u, bujq farmer, peasant *3*
bujqësi, -a agriculture *22*
búkë, -a, -ë bread, food *3*
(i) búkur beautiful, nice, pretty *10*
bukuri, -a beauty *10*
bullgárë Bulgarians *2†*
bullgari Bulgaria *2†*
bullgarisht Bulgarian *1†*
burg, -u, búrgje prison, jail *25*
burim, -i, -e spring, source *20*
(i) bútë soft, tender *20*
búrrë, -i, -a man *2*
byrék, -u, -ë meat or cheese pie *1†*

ca some *1.04*
cili, cila who, which *4*
(i) cili, e cila which, who, that *27*
të cilët which (masc. pl.) *29*
cilidó everyone, anyone *25*
cópë, -a, -ë piece *8*

ç' what
çádër, -a, -a tent, umbrella *19*
çaj, -i tea *1.04*
çaj, çarë chop, smash *23*
çakmák, -u, -ë cigarette lighter *22*
çalój limp (CF) *26*
çdo every *28*
ç'e do what is it for *16*
çel open (CF) *22*
çelin (they) open out, blossom (medio-passive) *22*
çiflig, -u, çifligje farm *21*
çifte, -ja, - double-barreled gun *22*
çikë, -a, -a bit, little piece *19*
çirák, -u apprentice *3†*
çlirój liberate, free (CF) *26*
çuditet gets surprised (medio-passive) *16*
çast, -i, -e moment *9*
ç'do të thótë what does ... mean *5*
çek, -u, -çeqe check *15*
çélës, -i, -a key *7*
çerék quarter, fourth *3*
çështje, -ja, - issue *10*
çfárë what *3*
çikë, -a little piece *8*
çoráp, -i, -e sock *9†*
ç'hënë what a moon! *11*

ç'ke what's wrong with you *14*
ç'kémi what's new *11*
ç'vend what country *5*
çlodh refresh (CF) *10*
çlóhet gets rested (medio-passive) *10*
çmim, -i, -e price *10*
çoráp, -i, -e stocking *15*
çudí, -a surprise, wonder *14*
është çudí it's amazing *26*
çúpë, -a, -a girl *11*

dájën uncle (mother's brother) *4†*
dal (del), dálë) emerge *10*
dál angarí go out to do compulsory labor *23*
dále just a moment! *20*
dárdhë, -a, -ë pear (tree) *8*
dárkë, -a, supper, dinner *8*
dásmë, -a wedding *9*
dáshur wanted (participle) *13*
(i) dáshur dear, wanted *17*
dátë -a, - date *25*
daúlle, -ja, - big drum *22*
dëgjój listen, hear (CF) *10*
dembél lazy *11*
dënój punish (CF) *17*
dérë, -a, dýer door *2*
derdh pour (CF) *17*
dérdhje, -ja, -, - pouring *17*
dérr, -i, -a pig, pork *8†*
désha (I) wanted (past def.) *17*

dëshpëroj sadden (CF) *25*
(i) dëshpërúar sad, desperate *25*
det, -i, -e sea *3†*
detýrë, -a, -a duty, obligation *23*
dëbórë, -a, -ra snow *5*
dërgój send (CF) *9*
dëshirój desire *1.04*
dollág, -i, -ë closets *7†*
drékë, -a, -a lunch *8†*
dré, -ri, -rë venison ("deer") *8†*
dýzet forty *X10†*
dy two *1*

dha (he) gave (past def.) *21*
dháshë (I) gave (past def.) *13*
dhe and *2*
dhe áq so much *8*
dhe më párë already *19*
dhe pak a little more *10*
dhe pastáj and in addition, and afterwards *20*
dhe únë me too *5*
dhe, -u, -ra land, earth *22*
dhemb hurt (CF *19*
dhen sheep (collective plural) *20*
dhëndër, -i, dhendurë bridegroom, son-in-law *14*
dhënë given (participle) *13*
dhi, -a, - goat *20*
dhjétë ten *1*
(i) dhjétë tenth *4†*
dhjetór, -i December *25*

dhómë, -a, -a room *7*
dhómë e pritjes living-room *11*
Dhórë (proper name) *2†*
di, ditur know *1.02*
diçká something *10*
(e) diel Sunday *16*
(të) dielën on (the) Sunday *16*
diéll, -i sun *5*
digjet gets burned *16*
dhigjet fyti the throat is parched *16*
dimër, -i, -a winter *5*
disá several *10*
ditë, -a, - the day *1.01*
ditë e flámurit flag day, independence day *27*
ditë me diéll sunny day *19*
ditën in the daytime *5*
djálë, -i, djem boy *2*
djáli im i madh my eldest son *2*
djathë, -i, -ra cheese *8*
djáthtas on the right *2*
to the right *21*
(i) djáthtë right *20*
(e) djáthta the right-hand one *1.03*
(e) djáthtë right-hand *1.03*
dje yesterday *3*
djeg, djégur (dógja) burn (CF) *16*
do want
dója (I) wanted, liked *15*
dó a s'dó like it or not *14*
do me thënë (it) means *17*
do të jétë might (will) be *26*
do të ketë vjédhur must (will) have stolen *16*
do të bëhet (he) wants to become *4*
do të bëjë (it) will do, make *5*
do të bjérë (it) will fall *5*
do të ha (I) shall eat *3*
do të hash (you/sg) want to eat *3*
do të kënáqeshe you would have fun *13*
do të prés (I) will wait *7*
do të shkonim we would go *13*
do të të shóh (I)'ll see you. *5*
do të thúash (you/sg) mean, want to say *10*
do të véte (I)'ll go *5*
do të véte të peshkój (I)'ll go fishing *5*
do të vish (you) want to come *2*
(i) dóbët weak *17*
doemós certainly, of course *11*
dogánë, -a, -a tariff, customs office *26*
doktór doctor *4*
dollárë dollars *1†*
domethënë that is, which means *13*
domosdó of course *28*
dórë, -a, dúar hand *21*
dórëz, -a, -a glove *26*
dot (not able) at all *11*
drejt straight *1.03*
drejt xhamisë straight to the mosque *2*
(i) dréjtë right, straight *14*
(e) dréjta the right one *14*
(e) dréjtë right, justice, truth *17*

(e) dréjtë right, straight *21*
drejtój direct, steer (CF) *25*
drejtór, -i, -ë supervisor, director *25*
drékë, -a, -a lunch *8*
dritáre, -ja, - window *7*
drizë, -a, a bush, thicket *22*
dru, -ri, -nj wood, tree *22*
dúa (do), dáshur (désha) want, like *1.04*
dúam we want *2*
duhán, -i, -e tobacco *3*
duhanxhi, -u, -nj tobacconist *3*
dúhet is necessary (medio-passive) *2*
must, should *27*
dúhen paraqítur (they) need presenting *27*
dúhet dërgúar (it) needs sending *27*
dúhet firmúar (it) needs signing *27*
(i) dúhur necessary, proper *25*
dúke (corresponds to *-ing* on end of English verbs) *14*
dúke bërë doing, making *14*
duke ndénjur staying, sitting *20*
dúke pritur awaiting, expecting *14*
dúket seems (medio-passive) *8*
dúkem I appear *11*
dúken (they) appear *5*
dúkuni show up! *11*
dúkje, -ja, - scene, appearance *22*
durîm, -i patience *16*
dushk, -u, dúshqe oak, acorn *20*
duzinë, -a, -a dozen *15*
dy twelve *1*
dymbëdhjétë twelve *2†*
(i) dymbëdhjétë twelfth *4†*
(i) dýtë second *4*
(e) dýta the second (feminine) *14*
dyqán, -i, -e store *2*
dyshék, -u, -ë mattress, bed *20*
dyzét forty *1†*

e and *1.04*
e it, him, her (pronominal proclitic)
e bëj hesáp (I) calculate it *20*
e bëj çështje make it an issue *10*
e dha shpírtin (he) gave up the ghost *21*
e kam për (I) consider it *20*
e kam për mirë (I) consider it lucky *20*
e ke kujdésin (you/sg) are cautious *23*
e mësúam (we) learned it *2*
e mësúat (you/pl) studied it *2*
e njeh (you/sg) know him *3*
e adjectival particle
e his, her, it, their (with kinship terms)
e ëma his or her or their mother *10*
e shóqe, -ja his spouse *27*
e hënë Monday *9*
ec walk! (you/sg) *2*
éci (ecën), écur go, move, walk *2*
edhé and, also, too *5*
édhë even, still *20*
edukój educate (CF) *23*
ej hey! *3*

ej éj hey hey! *10*
éja come! (you/sg) *2*
éjani come! (you/pl) *2*
ekzekutiv, -e executive *26*
ekzistój exist (CF) *29*
elb, -i, -ëra barley *22*
ëmër, -i, -a name *2*
énde still, yet *23*
érdhe (you/sg) came (past def.) *2*
ërë, -a, -ra air, wind *5*
ërë pa diéll dark atmosphere *5*
etj. (e të tjerë) etc. (and others) *25*
étje, -ja thirst *16*
éthet a fever *4†*

(i) émbël sweet *11*
ëmbëlsirë, -a, -a sweets, dessert *1†*
ëndërr, -a, -a dream *11*
është is *1.03*
është mbjéllur has been sown *20*
është e múndur it's possible *9*

fabrikë, -a, -a factory *9*
Faik, -u (proper name) *2*
fáj, -i, -e guilt, crime *17*
fál excuse (CF) *2*
(të) fála regards, greetings *23*
falemndérit I thank *1.01*
falemindérit we thank *2*
thanks *11*
fálet prays, beseeches (medio-passive) *11*
familje, -a, - family *4*
fanéllë, -a, -a sweater *9†*
fáqe, -ja, - face, picture *22*
fáre very, absolutely *11*
at all (with negative verbs) *16*
fárë, -a, -a seed *22*
farmaci, -a pharmacy *9*
fasúle, -ja, - beans *8†*
fat, -i, -e fate, luck *16*
fatkéq unfortunate, unhappy *26*
Fatósi (proper name) *2†*
fejóhet gets engaged (medio-passive) *10*
fejój affiance (CF) *10*
(i) fejúar, -i fiancé *10*
fëmijë, -a, - child, family *2†*
féstë, -a celebration, holiday *13*
festivál, -i, -e festival *28*
festivalist, -i, -ë festival participant *28*
film, -i, -a film *13*
fill, -i, fije thread *28*
fillim, -i, -e beginning, start *29*
fillój begin (CF) *16*
fillóre elementary, beginning *10*
firmój sign (CF) *27*
fis, -i, -e clan, tribe, genus *17*
fitoj win (CF) *16*
fitúes, -i, - winner *28*
fjálë, -a, - word *10*
saying *28*

fjálë e vjétër old saying, adage *25*
kishim lënë fjalë (we) had agreed *21*
fjalim, -i, -e speech *13*
fjalóset converses (medio-passive) *10*
fjétje, -a sleeping
dhoma fjetjes bedroom *X11†*
flákë, -a, -ë flame *22*
flámur, -i, flámuj flag *25*
fle sleep (CF) *11*
flas (flet), fólur 2
fol speak! (sg. command) *1.02*
flétë, -a, - leaf, leafy branch *20*
flok, -u, -ë hair *9*
folklorist, -i, -ë folklore scholar *28*
folklór, -i folklore *28*
fórcë, -a, -a force, power *23*
formóhet is formed (medio-passive) *29*
formój form (CF) *29*
fort extremely, very *7*
(i) fórtë strong *17*
(i) fórti the strong one (masculine) *17*
fóshnjë, -a, -a infant, baby, child *15*
fotografi, -a, - photograph *28*
fotografik, -e photographic *28*
Fráncë, -a France *2†*
francézë Frenchmen *2†*
(i) fréskët fresh, cool *8*
frëngjisht French *1†*
frikë, -a fear *8*
frúth, -i measles *4†*
frýhet swells, gets blown up (medio-passive) *22*
fryj blow (CF) *5*
fryn éra the wind blows *19*
fryn érë it's windy *5*
fshat, -i, -ra town, village, country *10*
fshatár, -i, -ë village, farmer *2†*
fsheh hide (something) (CF) *22*
fshihet hides itself (medio-passive) *22*
ftóhtë cold *X11†*
coldly *5*
(i) ftóhtë cold *4*
ftoj invite (CF) *14*
(i) ftúar invited *14*
(i) ftúari the guest *14*
fukará, -i, fukarénj poor man *23*
fund, -i, -e end, bottom *17*
fuqi, -a, - power *29*
fúrcë, -a, -a brush *9†*
fúrrë oven, bakery *3*
furrxhi baker *3*
fustán, -i, -e skirt, dress *9†*
fustanéllë, -a, -a pleated kilt *28*
futbóll, -i soccer *16*
(i) fýer offended, insulted *17*
fyt, -i, -e throat *16*
fytýrë, -a face, picture *13*

gabim, -i, -e mistake *20*
gabóhet is mistaken (medio-passive) *15*
gabój mistake (CF) *15*

gáti ready *5*
gatúaj cook, prepare (CF) *8*
gazetár, -i, -ë journalist *29*
gazétë, -a, -a newspaper *27*
gdhihet dawns (medio-passive) *19*
gégë, -e Gheg *5*
gënjéhet is deceived (medio-passive) *20*
gënjéj, gënjýer deceive, lie *20*
gëzóhet is glad (medio-passive) *2*
gëzúar gladdened (participle) *11*
gisht, -i, -ërinj finger *20*
gójë, -a, - mouth *14*
gomár, -i, -ë donkey *19*
gótë, -a, -a glass *8*
grá women *14*
grékë Greeks *2†*
Greqi, -a Greece *2†*
greqisht Greek *1†*
grip, -i flu *4†*
gris tear (CF) *27*
(i) grisur torn, tattered *27*
gropë, -a, -a hole, ditch *20*
grúa, -ja, gra woman, wife *2†*
grup, -i, -e group *26*
grúrë, -i wheat *22*
gur, -i, -ë stone, rock *20*
gusht, -i August *25*

gjah, -u game, hunt *28*
gjak, -u, -ja blood, blood vengeance *17*

gájle, -ja, - worry *10*
gjálpë, -i butter *8*
gjáshtë six *1*
(i) gjáshtë sixth *4†*
gjashtëdhjétë sixty *1†*
gjashtëmbëdhjétë sixteen *2†*
(i) gjátë long, tall *9*
(të) gjáta long (feminine plural) *9*
long ones *15*
gjë, -ja, -ra thing, a thing *25*
gjej, gjétur find *9*
guess *21*
gjéllë, -a, -ë food *8*
gjellëtore, -ja, informal restaurant *8*
gjéndet is situated (medio-passive) *29*
gjer up till *7*
gjer më until (followed by accusative) *7*
(i) gjérë wide *23*
gjermán, -i, -ë German *2†*
gjermani Germany *2†*
gjermanisht German *1†*
gjersá until, as long as *21*
gjësénd, -i something, event *21*
gjétkë elsewhere *25*
gjéthe, -ja, - leaf *22*
gjezdis sightsee, promenade (CF) *10*
gjë, -ja, -ra thing *3*
gjëkáfshë something *2*
gjëmón (it) thunders *5*
gjithashtú likewise *29*

gjithë all *7*
(i) gjithë all, entire *13*
të gjithave in respect to everything (dative) *23*
gjithnjé always *2*
gjoks, -i, -e chest *19*
gjol, -i, -e lake, pond *19*
gjúhë, -a, - tongue, language *11*
gjúmë, -i sleep *19*
gjyq, -i, -e judge, court *25*
gjýsmë half *3*
gjysmë órë half an hour *28*
gjysh, -i, -ër grandfather *23*
gjýshe, -ja, - grandmother *4†*
gjyzlýkë, -t glasses (plural only) *23*

ha, ngrënë (hëngra, hëngrëm) eat *3*
ha búkë eat a meal *8*
habér, -i, :e information *16*
háhet is eaten (medio-passive) *3*
hájde come along! (you/sg) *2*
hájdeni come along! (you/pl) *2*
hákë, -a, - just deserts *17*
hakmárrje, -ja, - revenge taking *17*
hállë, -a, -a aunt (father's sister or sister-in-law) *4†*
hamáll, -i, haméj porter *3*
hap open (CF) *14*
hap véshin open your ears! *14*
hápur opened, spread out (participle) *10*
(i) hápur open *7*
hápet is opened *7*

harrój forget (CF) *9*
hásem, -i, -ë personal enemy *17*
havá, -ja climate *19*
hedh throw (CF) *8*
hedh fára broadcast seeds *22*
hidh throw! (singular command) *8*
hékur, -i, -a iron *26*
hekurós I iron *9*
hekurúdhë, -a, - railroad *26*
heq pull, remove (CF) *26*
hiqe remove it! (sg.command) *26*
hérë, -a, - time, instance *10*
hérët early *8*
hesáp, -i, -e calculation, account *20*
hënë, -a, -a moon *5†*
hëngra I ate *8*
hi, -ri, -ra ash *26*
hiç not at all *3*
hiçasgjë nothing at all *3*
hídhet is thrown (medio-passive) *21*
hije, -ja, - shade, shadow *20*
hip mount, get on, get in (CF) *10*
histori, -a, - story, history *27*
(i) hóllë thin, skinny *15*
(të) hólla thin ones, coins, change *16*
horizónt, -i, -e horizon *26*
hotél, -i, -e hotel *1.03*
(i) húaj foreign *15*
humb lose (CF) *16*
humbás (humbét) lose *19*

(i) húmbur lost *17*
húndë, -a, - nose *26*
hyj enter (CF) *11*
hyr enter! (singular command) *14*

i adjectival particle
i them (3rd pl pronominal object clitic) *14*
i dóni you/pl want them *9*
i ka këmbët (it) has the legs *22*
i it, him, her (3rd sg pronominal referent clitic)
i jépja fórcë (I) would give it power *23*
i bie hit it *7*
i bie zíles ring the bell *7*
i biem përqárk qytétit we take a tour around the city *10*
i dháshë gruas I gave to the woman *13*
i lútem (I) pray to him *22*
i lútem Zótit (I) pray to the Lord *22*
i thónë (they) call it, say to it *15*
i thótë (it) says to it, calls it *20*
ia 3rd sg pronominal clitic combination
ia ke kujdésin (you/sg) are cautious *23*
ia márr (I) head for it *21*
ia márrim (we) take it from him *22*
ia merr këngës you/sg sing *14*
ia plotësójë pópullit fulfill it for the people *26*
idé, -ja, - idea *28*
iki (ikën) leave, go away (CF) *7*
ik leave! (sg.command) *26*
ik të ikim let's get going! *26*
ikën në mërgim (they) went into exile *29*
ikje, -ja, - leaving, departure *29*
iláç, -i, -e medicine *29*
im, -e my *2*
emri im my name *2*
im bir my son *13*
ime shóqe my girl-friend, my wife *13*
imja mine (fem.nominative) *27*
inspektór, -i, -ë inspector *26*
institút, -i, -e institute *28*
interesánt interesting *27*
interesój interest (CF) *29*
ishа (I) was *3*
ishim we were *9*
ishit (you/pl) were *17*
ishte (he) was *3*
Itali, -a Italy *15*
italián, -i, -ë Italian *2†*
italisht in Italian *1†*

ja look there! look here! *13*
pay attention *28*
jam be *2*
jam bërë have become *9*
jam keq be ill *20*
kam qenë keq have been ill *20*
jémi dúke prítur we are awaiting *14*
janár, -i January *25*
jánë they are *4*
jap (jep), dhënë (dháshë) give *3*
jep give! (singular command) *10*

jap bórxh lend, give loan *16*
jap fjálën give one's word, promise *13*
jep shëndét (it) gives health, is invigorating *20*
japonézë Japanese *2†*
japoni, -a Japan *2†*
jáshtë out, outside (dative) *9*
(i) jáshtëm, -e external *26*
javásh slowly *10*
jávë, -a week *8*
jávën in the week (accusative) *13*
je you/sg are *1.01*
jelék, -u, -ë vest *28*
jémi (we) are *2*
jéni (you) are *1.01*
jeshíl, -e green *15*
jétë, -a life *11*
jo no, not *1.01*
jo aq shúmë not so much *7*
jónë our *16*
jóte your/sg (feminine) *2*
(e) jótja yours, (the) your/sg (feminine) *14*
ju you/pl *1.01*
ju urój shëndét (I) wish health to you *21*
júve to you/pl *21*
júaj your/pl *13*
jug, -u south *5*
(të) júgut those of the south *5*
jugperëndimit southwest *7†*
Jugoslavi, -ja Yugoslavia *2†*
juri, -a, - jury *28*

ka there is, there are (literally: "it has") *1.03*
ka dítë since days *3*
ka, -u, qe steer *8*
kafé, -ja, - coffee *1.04*
kafenë, -a, - coffee house *1.03*
káfshë, -a, -a animal *20*
kalb rot (something) (CF) *23*
kálë, -i, kúaj horse *21*
kam (ke, ka), pásur (páta) have
kam dý dítë që it's been two days since I *9*
kam étje be thirsty *16*
kam fáj have guilt, be guilty *17*
kam frikë be afraid *8*
kam kóhë have time *9*
kam nevójë për have need of *7*
kam qejf enjoy *28*
kam máll miss *11*
kam qën have been *13*
kam méndjen be alert *20*
kam merák be worried *7*
kam ngé have plenty of time *5*
kam párë have seen *3*
kam qejf enjoy *8*
kam si have a way *11*
kam të dréjtë be right *21*
kam turp I am bashful *14*
ke të fála (you/sg) have regards *23*
kemi kërkúar we looked for (past indefinite) *10*
kemi múndur (we) have been able *22*
kéni árdhur (you/pl) have come *2*

329

kamión, -i, -ë truck *X10†*
kánë they have *8*
kapélë, -a, -a hat *26*
kaq this much, so much *8*
karshi opposite, facing (with dative) *14*
karrige, karrigia, - */fRchair* *7†*
karrócë, -a, -a carriage *X10†*
kasáp, -i, -ë butcher *9†*
kasólle, -ja, - hut, cottage *21*
kastile on purpose, especially *28*
Kastriót, -i Castrioti (Skandërbeg's real name) *27*
kat, -i, -e storey, floor *15*
kátër four
